



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	02.02.2018
Referencë	11-344/1
Për :	Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti
Nga :	Imer Rrustemi-Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit
Lënda :	RAPORTI MUJOR-JANAR

Pasqyra tabelare e punës për muajin –JANAR

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Inspektime për orar të punës	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Pëlqime sanitare	Menaxhim i tregjeve	Aktvendime- ndalesa,urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Të hyra nga pranimet teknike	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Inspektim për farëra,plehradhe pesticide	Biznese të pajegjistruara dhe pa pranime teknike	Mallë me afat të skaduar
Biznesit	151	23	7			14	4			4	30	69	250.0€					
Ambientit	59	18		3		3		1				31		3				
Bujqësisë																		
Ndërtimtarisë	8	1										7						
Trafikut	135	34		3		41				8				19	30			
Sanitar	93	30		4	20	24			1			9		5				61€
Gjithsejtë	446	106	7	10	20	82	4	1	1	12	30	116	250.0€	24	33			61€

Gjatë muajit janar kemi hasur në 23 biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjnë regjistrimin e tyre pranë qendres së regjistrimit të bizneseve ARBK-së, Lipjan. Gjithashtu kemi pasur shtatë biznese pa pranime teknik të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjienike ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtoratit të Inspektoratit. Në agjendën e inspektoratit gjatë muajit janar kanë qenë edhe inspektimi i supermarketeve ushqimore në lidhje me afatëshmërin si dhe çmimet e produkteve që janë plasuar për shitje në bazë të fletushkave që kanë shpërndarë.

Kontrollimi është bërë në të gjitha bizneseve duke krahasuar çmimin e raftit të shitjes me kuponin fiskal. Te asnjë nga bizneset nuk kemi has disproporcion çmimesh ngase i kishim ndëshkuar gjatë muajit dhjetor pesë supermarkete ku nga këto dy supermarkete dy herë janë ndëshkuar, kurse tri supermarkete nga një herë me fletëparaqitje për kundërvajtje.

Aksioni për verifikim çmimesh është në vazhdimësi edhe atë sa herë ka zbritje çmimesh.

Në bazë të planit të punës për vitin 2018, për muajin janar ishte e paraparë inspektimi i barnatoreve humane ku dhe kemi bërë inspektimin e barnatoreve në qytet dhe fshatra. Të gjitha janë inspektuar në aspektin higjieno sanitarë dhe gjatë inspektimit në disa prej tyre është gjetur mall me afat të skaduar më vlerë prej 61.3€, i cili mall është asgjësuar në vend dhe ndaj barnatoreve në të cilat është gjetur malli me afat të skaduar është bërë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje (fletëparaqitje).

Inspektorati gjatë muajit kemi inspektuar barnatoret shëndetësore në lidhje me orarin e kujdestarisë së barnatoreve. Gjatë një aksioni të natës një barnatore është ndëshkuar për mosrespektim të orarit kur barnatarët tjera të gjitha e kanë mirëpritur dhe e kanë respektuar orarin. Ky aksion i orarit të punës së barnatoreve vazhdon pa ndërprerë nga ana e inspektoratit

Këtë muaj si objekt inspektimi ishte edhe inspektimi i çerdheve të fëmijëve ku kemi inspektuar ato private dhe shtetërore. Gjatë muajit është bërë inspektimi i Qendrave të mjekësisë familjare nëpër fshatra rreth respektimit të Ligjit për Kontrollin e duhanit ku në asnjërën prej tyre nuk kemi hasur duke pirë duhan brenda hapësirës së mbyllur të këtyre qendrave.

Janë inspektuar deponitë ilegale të mbeturinave në qytet dhe disa fshatra, se mos po hasen qytetarë duke hedhë mbeturina për të marr masat ligjore ndaj tyre. Janë inspektuar hapësirat gjelbëruese në qytet duke i dhënë vërejtje disa qytetarëve për t'i larguar veturat që kanë parkuar në trotuare të parqeve. Është marrë aksion në f.sh. Kojkë në lidhje me mbeturinat duke i detyruar me procesverbal disa ekonomi familjare që të lidhin kontratë për mbeturina dhe ato t'i dorëzojnë Kompaninë Pastrimi.

Janë iniciuar fletëparaqitje për gjykatë ndaj bizneseve për shpërndarje të mbeturinave në hapësira publike dhe ndotje të ajrit për shkak të ndezjeve të mbeturinave.

Kemi dalë në vend ngjarje në bazë të kërkesave të palëve të cilat kërkesa kishin të bëjnë me mbeturinat dhe problemet me ujëra të zeza.

Është bërë inspektimi i kompanive të autobusëve të cilët operojnë në këtë territor të Lipjanit se mos ka ndonjë vonesë në rëndësi të udhëtimit, si dhe kontrollimi i auto-taksive që janë të parkuar në parkingjet e auto-taksit si në rrugën Lidhja e Prizrenit, Isa Olluri dhe Skënderbeu, dhe në ANP se po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtari ilegale, si dhe inspektimi i tregjeve si tregu i gjelbër, kafshëve dhe i mobileve.

Gjatë muajit janar ka pasur inspektime të pakta të ndërtimeve për arsye të kushteve klimatike-motit të ftohtë, reshjeve të borës e shiut. Janë inspektuar disa lokacione të vend ndërtimeve në terren.